Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula



Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË
Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit¹

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Në bazë të parashikimeve të neneve 28 dhe 37 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, ***me asnjë*** nga anëtarët e stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 10

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 11.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të dorëzojë vetdeklarimet, sipas kësaj Shtojce.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht¹;

b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 8;
- b. Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit, sipas Shtojcës 9;
- c. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Objekti i prokurimit (*projektim*) duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiro mesatare financiare vjetore pa TVSH, e realizuar nga Operatori Ekonomik perkatesisht ne tre vitet e fundit 2016, 2017 dhe 2018, dhe duhet te mos jete me e vogel se 40% e fondit limit te procedurës se prokurimit. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e percaktuar me siper:*

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem (te mos kete qene me humbje) gjate tre viteve te fundit 2015, 2016 dhe 2017. *Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të tre viteve të fundit, të paraqitur pranë autoritetit përkatës, të konfirmuara nga ky autoritet, si dhe te shoqeruara me akt ekspertizen e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar kontrata per shërbime te mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit një vlerë jo më pak se 40% e fondit limit dhe që janë realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontraten/kontratat e nenshkruar me AK-ne, vertetimin / certifikaten / cdo dokument qe jep te dhena mbi cilësinë e kryerjes se sherbimit kontraktor dhe faturat tatimore përkatëse qe vërtetojnë vlerën e realizuar.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore përkatëse që vërtetojnë vlerën e realizuar, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në çdo rast duhet të paraqitet dokumentacioni përkatës për të vërtetuar nëse shërbimi është i përfunduar apo është në proces.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar, me jo më pak se 18 punonjës, për periudhën (Shkurt 2018 - Shkurt 2019), e vërtetuar kjo me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve, shoqëruar edhe me Formularet e Deklarimit të Pagesave (me nënshkrim elektronik ose në hard copy).

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha shërbimeve, si më poshtë:

Stafi kryesor për shërbimin e projektimit

- a. Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) – Arkitekt me përvojë punë të ngjashme si drejtues projekti.
- b. Projektues Arkitekt me përvojë punë të ngjashme në projektim.
- c. Projektues Konstruktor me përvojë punë të ngjashme në projektim.
- d. Projektues Inxhinier Hidroteknik, me përvojë punë të ngjashme në projektim.
- e. Projektues Rruge, me përvojë në projektim.
- f. Projektues Elektrik

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale për stafin kryesor, operatorët ekonomik duhet të paraqesin diplomat, CV dhe kontratat e punës.

Stafi ndihmës për shërbimin e projektimit

- a. Projektues Gjeodet, me përvojë punë të ngjashme në projektim.
- b. Inxhinier Gjeolog
- c. Inxhinier Mjedisi

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale për stafin ndihmës duhet të paraqiten diplomat, CV dhe kontratat e punës apo marrëveshjet e bashkëpunimit.

Licencat që duhet të zotërojë stafi kryesor:

- Drejtues Projekti -Arkitekt (Drejtues i grupit të projektimit): Duhet të zotërojë license 2/a, b, c, d.
- Projektues Arkitekt: Duhet të zotërojë license 2/a, b, c, d.
- Projektuesi Konstruktor: Duhet të zotërojë licensë 3/a.
- Projektuesi Hidroteknik: Duhet të zotërojë licensë 5/c.
- Projektues për Rrugët: Duhet të zotërojë licensë 6/a.
- Projektues Inxhinier Elektrik: Duhet të zotërojë licensë 10/e.

Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti duhet të paraqesin licensat përkatëse.

Përvojat e mëparshme të stafit kryesor:

- Drejtues Projekti (Drejtues i grupit të projektimit) – Duhet të ketë realizuar jo më pak se 4(katër) projekte të ngjashëm, në projektim komplekse si sheshe, parqe, godina turistike, etj.
- Projektues Arkitekt: duhet të ketë realizuar jo më pak se 4(katër) projekte të ngjashëm, në projektim komplekse si sheshe, parqe, godina turistike, etj.
- Projektuesi Konstruktor: duhet të ketë realizuar jo më pak se 4(katër) projekte të ngjashëm, në konstruksion sheshe, parqe, godina turistike, etj.
- Projektuesi Hidroteknik: duhet të ketë realizuar jo më pak se 4(katër) projekte të ngjashëm, ujësjellësa/ kanalizime në sheshe, parqe, etj.
- Projektuesi i Rrugëve: duhet të ketë realizuar jo më pak se 4(katër) projekte të ngjashëm, projektim rrugësh në sheshe, në parqe, etj.
- Projektuesi Elektrik: duhet të ketë realizuar jo më pak se 4(katër) projekte të ngjashëm, projektim rrugësh në sheshe, parqe, godina turistike, etj.

Stafi kryesor i projektit duhet të jenë pjesë e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në Listë pagesat e punonjësve të shoqërisë për periudhën Shkurt 2018 – Shkurt 2019.

2.3.4 Operatoret ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin të miratuar. Liçensa profesionale e operatoreve ekonomik e lidhur me ekzekutimin e shërbimeve të kontratës objekt prokurimi, duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Liçensat e kërkuara në projektim:

- KATEGORIA	EMERTIMI
2 /a, b, c, d.	Projektim arkitekturor për objekte banimi-objekte industriale-objekte turistike; objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara, objekte social kulturore, vepra arti në infrastrukturë, projektim peisazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbërta, lulishte dhe parqe.
3/e.	Objekte civile - turistike prej druri.
4/c, i.	Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile dhe industriale; Projektim i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit të objekteve.
5/c.	Projektim, Ujësjetës – kanalizime urbane –rurale.
6/b.	Projektim rrugë urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore.
7/ a, b.	Projektim ura dhe vepra arti deri në 10m / Projektim ura dhe vepra arti mbi 10m.
10/e.	Kabina elektrike të rrjetit shpërndaresh- linja të tensionit të ulët –të mesëm.
11/a, b.	Projektim sinjalistike jondricuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytesore, rrugë interurbane dytesore, sheshe dhe parkime / sinjalistike jondricuese në autostrada, rrugë urbane kryesore, rrugë interurbane kryesore.

Gjithashtu Operatoret Ekonomike duhet të disponojnë dhe të paraqesin Licencë, Grupi 2- Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, Nënkatëgoria: Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me vlerësimin e ndikimit në mjedis-Kodi: III.2.

Shoëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim



Shtojca 11**DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME**

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale,
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv),
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 12

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sipas termave të references.




Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01		
02		
03		
...		



Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Sipas termave të references.

Afatet e ekzekutimit:



2 muaj nga data e lidhjes së kontratës

Shtojca 15

TERMAT E REFERENCËS

Termt e References

Për projektimin e objektit: “Vazhdimi i Shëtitores së Vlorës-

Segmenti jugor nga fushat sportit deri tek tuneli

Objektivi

Objektivi kryesor i projektit: “Vazhdimi i Shëtitores së Vlorës - Segmenti jugor nga fushat sportit deri tuneli” është rritja e kapaciteteve të infrastrukturës urbane e turistike të zonës, si dhe krijimi i ambjenteve çlodhëse e kreative.

Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është përgatitja e projektit të zbatimit për këtë zonë.

Të dhëna mbi gjendjen ekzistuese të zonës së projektit

Objekti: “Vazhdimi i Shëtitores së Vlorës - Segmenti jugor nga fushat sportit deri tuneli” ndodhet në pjesën jugore të fushave të sportit në shëtitoren e re të ndërtuar në Vlorë (shiko fig. 1).




Fig. 1 – Vazhdimi i shëtitorës jugore

- Zona ku do të zhvillohet projekti është e crregullt dhe pa një shëtitore ku të shfrytëzohet bukuria e natyrës që e rrethon (shiko Fig. 2).
- Zona tjetër që është trotuari sipër rrugës automobilistike është në gjendje shumë të degraduar dhe vënde vënde të dëmtuar dhe shumë të rrezikshme për kalimin e këmbësorve. Gjithashtu edhe largimi i ujërave të bardha nga rruga automobilistike bëhet në mënyrë primitive në tre pika shkarkimi në det pa asnjë infrastrukturë nëntokësore.




Fig.2 Sipërfaqja e zonës së shëtitorës jugore

Ndërrhyrjet e propozuara

Projektuesi duhet të analizojë të dhënat e të projektojë hapësirën e shëtitorës dhe hapsirave publike me një sipërfaqe rreth 16,000 m².

Projekti parashikon krijimin e shëtitorës së re nga fushat e sportit deri te tuneli prej 600m në bregdet me qëllim krijimin e një pamjeje të bukur si dhe lidhjen hapësinore, funksionale e estetike ndërmjet fushave të sportit e shëtitorës së ndërtuar në fazën e parë me tunelin. Shëtitoret do të ketë të njëjtat karakteristika si shëtitoret e ndërtuar më parë me një gjerësi prej 7m prej betoni me zall të bardh lumi. Do të kemi ndricim, gjelbërim (pisha të buta), stola dhe akseset me trotuarin e rrugës sipër.

Gjithashtu do të realizohet akseset nga shëtitoret në det me anë të shkallareve që zbresin deri në det, të cilat do të shërbejnë edhe si mbrojtje detare. Përveç shëtitorës projekti parashikon dhe krijimin e hapsirave publike në zonën e re që do të krijohet nga shëtitoret te rruga automobilistike. Konkretisht këto zona publike do të jenë si: ndërtimi i dy pishinave publike, dushe, ndërtimi i një shatervani dhe i disa zonave plazhi, etj.

Pjesë e rëndësishme e projektit do të jetë ndërtimi i trotuarit të ri sipër rrugës automobilistike duke përfshirë sistemimin dhe largimin e ujërave të bardha të rrugës.

Hartimi i projektit duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit dhe do të bazohet në vëzhgimet e matjet topografike që do të kryhen në terren, studimet gjeologjike, hidrologjike, etj. Grupi i projektimit duhet të kryejë vlerësimin e gjendjes reale dhe të zgjidhë problematikat me qëllim realizimin e një projekti me standarde të larta.

Ndërhyrjet e propozuara në zonën e projektit, do të jenë:

- Punime për ndërtimin e shëtitores
- Punime për ndërtimin e hapësirave publike
- Ndërtimi i dy pishinave publike
- Ndërtimi i një shatërvani
- Ndërtimi i trotuarve të reja
- Ndërtimi i mureve mbajtëse poshtë trotuareve
- Ndërtimi i shkallareve të shëtitores
- Ndërtimi i mbrojtjes detare
- Zona kreative për fëmijët, familjet e të rinjtë, etj
- Punime për zgjidhjen e infrastrukturën mbitorësore e nëntokësore, si KUB, KUZ,
- Punime me ujësjellësin për furnizimin e pishinave, shatërvanit dhe dusheve
- Punime ndriçimi
- Punime sinjalistike
- Punime gjelbërimi
- Mobilim urban, dushe, stola, kosha mbeturinash, etj

Shërbimet e kërkuara

Shërbimet e kërkuara do të jenë në përputhje me VKM 354, datë 11.05.2016, faza I-VI

Mbledhja e të dhënave të gjendjes ekzistuese, analizimi i gjendjes ekzistuese dhe identifikimi i problematikave që ndikojnë në hartimin e projektit

Kjo fazë përfshin përcaktimin dhe identifikimin e kërkesave të projektit, mbledhjen e dokumentave ekzistuese. Konsulenti fillimisht informohet e studjon zonën. Gjithashtu konsulenti mban kontakte e bashkëpunon ngushtë me investitorin e me bashkinë. Për këtë fazë konsulenti përgatit një material në të cilin parashtrohet e gjithë analiza që i bëhet gjendjes ekzistuese duke identifikuar burimet, problematikat e propozime.

Përgatitja e projekt-idesë paraprake

Për këtë fazë konsulenti duhet të përgatisë:

- Vizatimet e zgjidhjeve të mundshme alternative (më shumë se një variant) duke studjuar dhe përcaktuar ndikimet e tyre sociale, ekonomike e mjedisore.

- Raportin ku përshkruhen të gjitha variantet e propozuara teknikisht me avantazhet e disavantazhet
- Preventiv paraprak për secilin variant
- Një prezantim të projektit përpara përfituesit dhe autoritetit kontraktues

Përgatitja e projekt-idesë përfundimtare

Për këtë fazë konsulenti duhet të përgatisë:

- Vizatimet e variantit të përzgjedhur nga projekt-idea paraprake
- Raportin teknik ku përfshihen mbledhja e dokumentave dhe studimeve ekzistuese, rilevimi i zones, raport topografi, hidrologjik, etj
- Preventivin e detajuar
- Një prezantim të projektit përpara përfituesit dhe autoritetit kontraktues

Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit

Përgatitja e projekt-zbatimit

Pas miratimit nga Autoriteti Kontraktues, projektuesi do të vazhdojë me përgatitjen e projektit të detajuar të zbatimit, duke përfshirë minimalisht por jo të kufizuar, si më poshtë:

- Vizatime
- Raportin teknik përfundimtar
- Preventiv (me dhe pa çmime)
- Specifikime teknike
- Grafik punimesh
- Plan shpronësimesh (nëse ka)
- Raporti i VNM

Vizatime

Vizatimet duhet të përmbajnë minimalisht fletët e mëposhtme

1. Horografinë e zones
2. Planimetrinë ekzistuese të zonës (ku paraqiten të gjithë elementët e infrastrukturës tokësore e nëntokësore)
3. Projekti urban e arkitektonik i propozuar i zonës
4. Projekti konstruktiv
5. Projektin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe kanalizimeve
6. Projektin e furnizimit me ujë të pishinës, duzeve dhe shatervanit
7. Veprat e artit dhe detaje
8. Projektin mekanik
9. Projektin elektrik të ndricimit
10. Projektin e gjelberimit

11. Projektin e sinjalistikes
12. Projektin e mobilimit urban
13. Detajet e ndryshme si psh: te trotuarit, mureve mbajtese, shkalleve, bordurave, parkimit, mobilimit urban, pishinave etj
14. Fotomontazh
15. Pamje tre dimensionale etj
16. Një katalog te stolave, shtyllave të ndriçimit, shtresave dhe pajisjeve të tjera urbane që mund të përdoren në zgjatjen në të ardhmen të shëtitores për të krijuar një shëtitore të vazhduar me identitet unik.

Raport teknik

Në raportin teknik përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin duke shpjeguar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen egzistuese, jepen llogaritjet e kryera, llogaritja e veprave të artit, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, etj Në raportin teknik do të përfshihen raporti përfundimtar i studimit topografik, i studimit gjeoteknik dhe investigimit të materialeve, raporti hidrologjik e hidraulik, raporti arkitektonik, konstruktiv, etj

Preventivi

Llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi.

Zërat e punimeve që nuk përfshihen në manualin teknik të çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me analizën llogaritjes së çmimit e t'i bashkëngjiten preventivit.

Specifikime Teknike

Projektuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të jepet:

- Përshkrimi i detajuar i zërit të punës, materialet që do të përdoren, cilësia e tyre
- Metoda e kryerjes së punimeve
- Cilesia e kërkuar e punimeve
- Formatet e lejuara
- Ngjyra e rekomanduar
- etj

Grafiku i punimeve

Grafiku i punimeve të hartohet bazuar në zërat e punës sipas preventivit dhe teknologjinë e punimeve

Planin e shpronësimeve (nëse ka)

Në planin e shpronësimeve të përfshihet planimetria me zonat kadastrale, si dhe lista e pronareve me sipërfaqen perkatese.e konfirmuar nga ZRRPP

VNM

Raporti i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis të përgatitet sipas legjislacionit në fuqi.

Standarde në Projektim

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standardeve, madje edhe atyre gjate zbatimit. Është përgjegjësi e projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standardeve dhe normave përkatëse.

Në hartimin e projektit të mbahen parasysh të gjitha normat e miratuar për personat me aftësi të kufizuara, të verberit, etj. Në projekt të parashikohet infrastruktura e nevojshme për këtë kategori.

Detajet teknike të infrastruktures për këtë kategori, të jepen nga projektuesi në fletë të veçanta të Projektit.

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës.

Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të kihet parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

Rekomandime për projektuesin

- Projektuesi duhet të përdorë dhe të rishikojë të gjithë informacionin egzistues lidhur me zonën.
- Projektuesi duhet të përdorë studimet, të dhënat paraprake, dokumenta që disponohen nga Bashkia Vlorë, seksioni i Urbanistikës dhe nga Kadastra.

Dorëzim dokumentacioni teknik dhe afatet

Dokumentat që duhen dorëzuar dhe afatet janë:

Dokumentacioni	Numri i kopjeve		Afati
	Kopje te printuara	CD	
Analiza e gjendjes ekzistuese dhe Projekt-idea paraprake (se bashku me dokumentacionin shoqerues)	1 (një) origjinal në anglisht dhe 1 (një) në shqip	1	3 jave pas lidhjes së kontratës*
Projekt-idea perfundimtare (se bashku me dokumentacionin shoqerues)	1 (një) origjinal në anglisht dhe 1 (një) në shqip	1	1.5 muaj pas lidhjes së kontratës*
Projekti i zbatimit (se bashku me dokumentacionin)	1(një) në anglisht dhe 4 (katër) në	2	2 muaj pas lidhjes së kontratës*

shoqerues: raport, specifikime teknike, preventivi me cmime e pa cmime, grafiku i punimeve)	shqip		
VNM	1(një) në anglisht dhe 4 (katër) në shqip	2	2 muaj pas lidhjes se kontrates*
Planet e shpronesimit	1(një) në anglisht dhe 4 (katër) në shqip	2	2 muaj pas lidhjes se kontrates*

- Ne afate perfshihen dhe koha 1 javore per komentet e klientit dhe 1 jave per korrigjimet nga konsulenti.

Vizatimet dhe raportet duhet të përgatiten e dorëzohen në origjinale të printuara sipas tabelës së mesiperme . Krahas tyre do të dorëhet dhe 1 (një) CD me të gjitha materialet në formatet përkatëse (acad, word, excel, avi, etj. dhe 1 (një) CD ne PDF.

Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuara duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga të gjithë projektuesit.

Koha e realizimit të projektit

Projekti i zbatimit duhet të përgatitet e dorëzohet brenda një afati kohor prej 2 muajsh.



Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR¹

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u skualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data _____]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	Vlera (me numra dhe fjale) _____
2. _____	Vlera (me numra dhe fjale) _____
Etj. _____	Vlera (me numra dhe fjale) _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
2. _____

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]* se oferta e paraqitur nga ana juaj dhe e vlerësuar me _____ pikë, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 49 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]



Shtojca 18

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të suksesshëm]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Pikët _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Pikët _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 19

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet e Konsulencës

Neni 1 Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2 Përkufizime

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjijtjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas

dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.
- 2.8 “Termat e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

Neni 3 Hartimi i Kontratës

- 3.1 Shpallja e fituesit do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4 Praktikë Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autortiteti Kontraktues mund t’i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë si rezultat i ose në lidhje me, këtë kontratë.
- 4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 5 Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktuesi mund t’i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premtonte ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6 Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t’i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t’i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.
